



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 14

Datë: 25. 04. 2023. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shpallja e Rezultateve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të KQZ-së për Kuvendin e Republikës së Kosovës - 2022

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Pasi që përshëndeti anëtarët e KQZ-së, dhe të tjerët pjesëmarrës në zgjedhje, kryetari Kreshnik Radoniqi, paraqiti rezultatet e zgjedhjeve të 23 prillit, 2023: për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

Fillimisht, anëtarët e KQZ –së miratuan rendin e ditës me 10 vota, ndërsa kryetari Radoniqi duke theksuar se nuk ka pasur asnjë raport për ndonjë ankesë, ose ngjashëm, pas numrimit të fletëvotimit, janë si në vijim:

Kreshnik Radoniqi:

Në komunën e Leposaviqit, Lëvizja “Vetëvendosje!” me kandidatin Lulzim Etemi, ka marrë 100 vota apo 73.5%.

Partia Demokratike e Kosovës, me kandidatin Albulenea Behluli - Etemi ka marrë 34 apo, 25%.

Partia “Kosovski Serba” me kandidatin Aleksandër Jabllanoviq, ka marrë 2 vota, apo 1.5%.

Lulzim Etemi është fitues. Kush është për...?

Me 9 vota për, 1 votë abstenim miratohet.

Në komunën e Zubin Potokut, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me kandidatin Izmir Zeqiri, ka fituar 197 vota dhe 52.2 %.

Izmir Zeqiri, shpallet fitues me 52.2 %, të votave. Kush është për miratim të kandidatit ?

Me 9 vota për dhe 1 abstenim, miratohet.

Lëvizja “Vetëvendosje!”, me kandidatin Flatron Hasani, ka fituar 180 vota, apo 47.7%.

Në komunën e Zveqanit:

Subjekti politik PDK me kandidatin Ilir Peci, ka fituar 114 vota, apo 59%.

Lëvizja “Vetëvendosje!”, me kandidatin Fetah Peci, ka fituar 72 vota, apo 37.3%.

Sllaxhona Pantovqi, ka fituar 7 vota, apo 3.6%.

Ilir Peci, shpallet fitues. Kush është për.

Me 9 vota për dhe 1 abstenim, miratohet.

Në komunën e Mitrovicës së veriut:

Lëvizja “Vetëvendosje!”, me kandidatin Erden Atiq, ka fituar me 553 apo 66.9%.

Partia Demokratike e Kosovës, me kandidatin Taulant Kelmendi ka fituar 193, apo 23.4 %.

Iniciativa Qytetare “Mitrovica”, me kandidatin Betim Osmani, ka fituar 80 vota, me 9.7%

Kandidati Erden Atiq, është fitues me 66.9%.

Me 9 vota për dhe 1 abstenim, miratohet.

Rezultatet për Asamble:

Në komunën e Leposaviqit, Lëvizja “Vetëvendosje!”, me 85 vota apo 77.3%, ka fituar 15 ulëse.

Partia Demokratike e Kosovës, me 21 vota apo 19.1 %, ka fituar 2 ulëse.

Partia “Kosovski Serba”, 4 vota, apo 3.6%, me dy ulëse të fituara.

Me 9 vota për dhe 1 abstenim, miratohet.

Në komunën e Zveqanit:

Partia Demokratike e Kosovës, me 93 vota apo 60.1 %, ka fituar 11 ulëse.

Lëvizja “Vetëvendosje!”, me 65 vota apo 39.9% ka fituar 8 ulëse.

Me 9 vota për dhe 1 abstenim, miratohet.

Këto janë rezultatet, tha në fund z. Radoniqi. Palët e pakënaqura, kanë të drejtë ankese deri nesër në ora 14:00.

3 Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Njoftim lidhur me raportin vjetor të KQZ-së për Kuvendin e Republikës së Kosovës – 2022:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar një draft ë raportit vjetor të punës së KQZ, që duhet dorëzuar në Kuvend. U është dorëzuar më herët, besojmë se deri të premtën do të përfundohet dhe do të na sillët për miratim...

Kreshnik Radoniqi: Rezultatet më të detajuara do të shpallen në ueb faqen e KQZ-së...

Të ndryshme!